

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN –Departamenti i Përgjithshëm , përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Islam Thaçi , me sekretaren juridike Rafete Syla në lëndën penale kundër të pandehurve: S. K., për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par. 1 i KPRK-së , B. R. dhe M. R. , për shkak në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale , lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nen par. 1.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP.II.nr. 352/17 të dt. 10.03.2017, të cilën e përfaqëson prokurorja e shtetit, Rozelida Hasani , pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më datën 28.03.2017 shpalli publikisht, ndërsa më dt. 03.04.2017, hartoi këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri **S. K.**, nga babai Sh. dhe nëna R. e lindur S. i lindur më dt. ... në Gj., me vendbanim në rr. "... nr. ..., ka të kryer ..., ... martuar, i gjendjes së ... ekonomike, shqiptar, i R. Të Kosovës, me parë i pa dënuar si dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij, i ndaluar prej dt. 15.02.2017, në ora 16,15.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më dt....2017 rreth orës ..., në stacionin policor në Gjilan, pas mosmarrëveshjeve me dy të pandehurit e parë të cilët raportojnë rastin në stacion të policisë, ky i pandehuri me ti vërejtur këta të dyshuar në këtë stacion policor të pandehurin M. R., e sulmon fizikisht, duke e goditur me grushta në pjesë të fytyrës.

Me çka ka kryer veprën penale , sulmi nga neni 187 paragrafi 1 të KPRK-së ,

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve: 4, 7,41,45, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e GJYKON :

DËNIM ME BURGIM

Ashtu që të pandehurit S. K., i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, i cili dënim do të ekzekutohet, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform neni 83 të KPRK-së, të pandehurit koha e kaluar në paraburgim nga dt. 25.02.2017 e deri më dt. 17.03.2017 do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar me burg.

Detyrohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor ne shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet I formës se prerë.

A r s y e t i m

PTH.DP në Gjiilan, ka ngritur aktakuzën, PP.II.nr. 352/17 të dt. 10.03.2017 kundër të pandehurve: S. K. , për shkak të veprës penale, sulmi nga neni 187 par. 1 i KPRK-së , B. R. dhe M. R., për shkak në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale , lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nen par. 1.1 pika 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe publik në të cilën ka prezantuar prokurorja e shtetit Rozelida Hasani , të pandehurit S.K., B. R. dhe M. R.,

Gjykata me qëllim të efikasitetit dhe moszvaritjes së procedurës penale në kuptim të nenit 36 të KPPRK-së , **ka veçuar** për të pandehurit : B. R. dhe M. R., e cila lëndë do të shqyrtohet dhe vendoset ndaras.

Prokurorja e shtetit pas leximit të aktakuzës në tërësi ka mbetur pranë pretendimeve të theksuara si në diapozitivin e së njëjtës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ti shqiptoj dënimin meritor në pajtim me Kodin Penal.

I pandehuri S. K., pasi që u njoftua me aktakuzën përkatësisht veprën penale e cila i vihet në barrë, i njëjti deklaroi se e pranojë fajësinë komfor dispozitivit të aktakuzës.

Me që i pandehuri **S. K.** në shqyrtimin e sotëm fillestar , vullnetarisht e pranojë fajësinë, gjykata konstatoi se janë përmbushur të gjitha kërkesat për pranimin e fajësisë komfor nenit 248, të KPPRK-ës.

Prokurorja e shtetit Rozelida Hasani, në fjalën përfundimtare deklaroi: duke u bazuar në faktin se i pandehuri S. K., e ka pranuar veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze edhe pas njoftimit të kësaj gjykate , lidhur me pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë , mbetem në tërësi pranë kësaj aktakuze dhe kërkoj nga gjykata që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj me dënim sipas ligjit. Me rastin e përcaktimit dhe llojit të dënimit i propozoj gjykatës që të ketë parasysh shkallen e përgjegjësisë penale , rrezikshmërinë shoqërore të kësaj veprë penale , gjithashtu i propozojmë gjykatës që me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit ti ketë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese dhe ato rënduese.

Mbrojtësi i të pandehurit S.K. av. A. T. deklaron: Meqenëse i mbrojturi im vullnetarisht e ka pranuar fajësinë kërkoj nga gjykata që gjatë matjes së lartësisë dhe llojit të sanksionit penal të merr parasysh pranimin e fajësisë , fakti që i mbrojturi im nuk ka qen i dënuar asnjëherë, bashkëpunimin me organet e drejtësisë dhe rrjedhimisht ti shqiptoj një dënim sa më të butë, gjithashtu i ka propozuar gjykatës që ndaj të pandehurve , ta ndërpres masën e paraburgimit.

I pandehuri S. K. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: në tërësi e përkrahu fjalën e mbrojtësit tim , andaj kërkoj nga gjykata që brenda mundësive të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Duke u bazuar në aktakuzën përkatësisht veprën penale me të cilën ngarkohet i pandehuri si dhe pranimin e fajësisë nga i njëjti , gjykata konstatoi se te i i

pandehuri qëndrojnë të gjitha elementet e kryerjes së veprës penale, sulmi nga neni 187 par. 1 të KPRK-së, për qka është edhe penalisht përgjegjës, andaj edhe të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit me kusht si në dispozitiv të aktgjykimit, ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73,74, 75 dhe 76 të KPRK-ës. Ku si rrethana lehtësuese ka marrë për bazë, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sjelljen korrekte në gjykatë, pendimin për kryerjen e veprës penale, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të kësaj natyre, ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori parasysh shkallen e përgjegjësisë penale, si dhe dënimin e shkaktuar të dëmtuarave.

Sipas bindjes së kësaj gjykate dënimi me burgim, sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi është i drejtë në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, andaj gjykata konsideron se përmes dënimit me burg do të arrihet qëllimi i dënimit. Nga neni 41 të KPRK-ës, si dhe ky dënim do të ndikojë në të pandehurin dhe personat potencial, me qëllim që në të ardhmen të përmbahet nga kryerja e veprave tjera penale.

Të pandehurve të larte cekur, iu është ndërpre masa e paraburgimit me aktvendim të vaqant.

Shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 par. 1 e lidhur me nenin 450 par. 1 nën par. 2.6 të KPRK-ës.

Nga të cekurat më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
Më 03.04.2017

Sek.juridike,
Rafete Sylaj, d.v.

Gjyqtari i vetëm gjykues
Islam Thaçi, d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, departamenti i përgjithshëm në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga data e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.